

Editorial/

NJË PIKËPAMJE SHUMË E NGUSHTË E FETARES

Nga Sami Mexhid



Muslimanët kanë të përbashkët principin e monoteizmit dhe bazat e besimit të tyre kolektiv. Megjithatë, ata e kanë këtë të përbashkët, ata ndryshojnë në nivelin e fetarsisë dhe devotshmërisë së tyre ose nivelin e gjynaheve dhe keqbërjeve. Disa janë me të vërtetë shtypës të vetë shpirtërave të tyre, disa janë të etur për të bërë vepra të mira dhe të tjerët janë diku në mes. Kjo pabarasi midis muslimanëve nuk e nxjerr asnjërin prej tyre jashtë lidhjeve të besnikërisë dhe dashamirësisë që duhet të ekzistojë midis tyre. Të gjithë atyre i janë premtuar “kopshtet e përrjetshme në të cilat ata do të hynë”. Edhe ata të cilët janë keqbërës ndaj shpirtit të tyre në fund të fundit do të hynë në Parajsë.

Ka shumë mënyra sesi një person mund ta dëmtojë vetë shpirtin e tij. Në fakt ka aq shumë mënyra sa ka edhe mënyra për të bërë gjynah. E njëjta mund të thuhet rreth devotshmërisë. Ka rrugë të panumërta për të bërë mirë. Ashtu si zjarri i Ferrit ka shtatë dyer, Parajsja ka tetë. Do të ketë njerëz që do të thirren nga njëra prej këtyre dyerve; disa do të thirren nga të gjitha dyert e Parajsës. Kjo na tregon se ka më shumë sesa një manifestim të devotshmërisë. Ajo nuk ka vetëm një fytyrë. Ne nuk mund të pikturojmë një pikturë të vetme dhe të themi, “Kjo është çfarë kuptojmë

me devotshmëri. Nuk ka asgjë tjetër”.

Megjithatë, janë ata të cilët veshin një lloj veshjeje dhe paraqitjeje të jashtme dhe e përdorin si masën e vetme të devotshmërisë së një personi. Ngushtimi i nocionit të fetares në paraqitjen e jashtme në vend të esencës së një personi ku paraqitjet e jashtme bëhen faktorë të vetëm kualifikues për fetaren. Kështu me mentalitetin se prezenca nuk kërkon asgjë tjetër dhe mungesa e saj nuk mund të kompensohet me asgjë tjetër është një nga gabimet më të mëdha të rizgimit të tanishëm islam.

Rizgjimi islam kasjellur ndryshime në shoqëri, shumë më shumë sesa një ndryshim në dukje. Ai ka qenë një rizgim në besim, në diskutimin intelektual, në metodologji, në etikë dhe në ndjenja emocionale. Megjithatë, terminologjia që ka lindur në këtë rizgim, si termi i “fetares” nuk përfaqësojnë një spektrum të gjerë të kuptimeve ose shprehu efektin total që rizgjimi ka patur në njerëz. Këto terma mbeten si të kufizuar me qëllim dhe superfaqësorë në kuptimin që në ditën kur së pari u citua.

Termi “fetare” është i kufizuar vetëm tek pamja e jashtme. Të dyja janë aq të lidhura bashkë sa kushdo që e ka paraqitjen menjëherë deklarohet fetarë dhe i devotshëm, çfarëdo keqbërjesh të mund të ketë bërë. Ndërsa, kushdo që nuk e ka paraqitjen

në çdo mënyrë të rëndësishme zhvishet nga epiteti i fetarit.

Të gjitha cilësitë e tij të tjera të mira nuk do t’ja japin atij këtë nder, nuk ka rëndësi sesa më shumë të rëndësishme sesa paraqitja ato cilësi mund të jenë. Ne i shohim sesa të padrejta dhe arbitrare gjykime të tilla janë, nderet i jepen pas një shikimi të tërthortë në paraqitjen dhe stilin e personit. Të tilla vëzhgime, në të vërtetë, janë pagojce. Ata nuk na tregojnë ne asgjë se çfarë personi thotë ose bën ndërsa janë fjalët dhe veprat e personit ato që na tregojnë se kush është dhe çfarë bën. Megjithatë, këto gjykime të përmbledhshme kalojnë nga një gjuhë te tjetra, përdërisa ata bëhen standarte me të cilat njerëzit vlerësojnë devotshmërinë dhe virtytin.

Duhet ta pranojmë se ne nuk mund të vlerësojmë karakterin e të tjerëve përveç nga çfarë ata na tregojnë për së jashtmi. Ashtu siç Umari ka thënë: “Ne do të të mbajmë në llogari për çfarë është e dukshme për ne nga veprat e tua”. Megjithatë, ne duhet të kuptojmë që janë sjelljet, morali dhe ajo çfarë personi thotë që e bën këtë aspekt të jashtëm të një personi, jo vetëm paraqitjen e jashtme. “Paraqitja” e një personi nuk tregon asgjë më shumë ose më pak sesa vetvetja. Nuk thotë asgjë tjetër. As nuk mohon asgjë tjetër. Nuk ofron burimin e lavdërimit ose dënimit jashtë vetes së saj. Umari ka folur rreth veprave, jo rreth veshjes dhe paraqitjes.

(Vijon në faqen 3...)

Fq.4/ Disa koncepte të gabuara të adhurimit dhe moralit Islam tek masa e shqiptarëve (3)

Nga hoxhë Emerim Koçi

Fq.5/ Aktualitet/ Goditet “Terrorizmi” në Shqipëri, apo goditje terrori?

Nga hoxhë Bilal Shkrepi

Fq.7/ Edukata mbi mënyrën e kryerjes së nevojës personale në

Nga Dr. asc: Gerald Xhafer Hala

Fetva/

Deklaratë e Asamblesë Ndërkombëtare të Jurisprudencës Islame në lidhje me ngjarjet në vendet arabe dhe në disa vende islame

Përgjigje:

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve, paqja dhe bekimet e qofshin mbi Muhamedin, vulën e profetëve dhe të dërguarëve, mbi familjen dhe gjithë shokët e tij:

Asambleja Ndërkombëtare e Jurisprudencës Islame që buron nga Konferenca Islamike për Bashkëpunim, në seancën e saj të 21-të, të mbajtur në qytetin e Rijadit në Arabinë Saudite, nga data 15 deri 19 Muharem 1435 H, që i përkon datës 18-22 Nëntor 2013, me cilësinë e një reference juridike për umetin islam dhe duke ndjerë përgjegjësinë që i bie në supe nisur nga detyrimi që ka karshi umetit, i cili po përballlet me sfida dhe rreziqe, sidomos me ngjarjet e fundit në vendet arabe dhe në disa vende islame, ka ndjekur me vëmendje atë që po ndodh në hapësirat arabe dhe islame në shumë vende, konfliktet, fitnet dhe sfidat që po fryjnë përballë umetit, që po rrezikojnë strukturën, unitetin, sigurinë dhe ekonominë e tij, sfidat që po i vendosin popujt në thundrën e padrejtësisë, urisë, frikës, përçarjes, mungesës së autoritetit, ndalimit të jetës dhe lëkundjeve të sistemeve dhe sigurisë.

Duke u nisur nga detyrimi i Asamblesë karshi umetit islam dhe duke u bazuar mbi vendimet që Asambleja ka nxjerrë në seancat e mëparshme në lidhje me Sirinë, ne i drejtohemi me këtë thirrje bijëve të umetit islam, udhëheqësve, dijetarëve dhe pushtetarëve, sidomos të atyre vendeve që po vuajnë nga këto sprova dhe konflikte se:

1- Konfirmojmë shenjtërinë e gjakrave, mbrotjen e shenjtërisë së muslimanit dhe mos-marrjen e guximit për të cënuar njerëzit, duke u nisur nga thënia e Allahut të Lartësuar: **“E kush vret një shpirt (njeri) apo bën trazirë në tokë është sikur ka vrarë gjithë njerëzit, e kush e shpëton atë është sikur ka shpërtuar të gjithë njerëzit”** dhe duke u nisur nga thënia e të dërguarit të Allahuat a.s.: **“Çdo musliman e ka haram për**

çdo musliman gjakun, pasurinë dhe nderin e tij...”

2- Konfirmojmë unitetin e umetit musliman dhe territorin e tij, mos-dhënien e ndihmës apo pjesëmarrjen për të përçarë unitetin e këtyre vendeve dhe shoqërive, si dhe konfirmojmë unitetin kombëtar që garanton lidhjen e këtyre vendeve, forcën e tyre dhe parandalon konfliktet e brendshme në to.

3- Konfirmojmë domosdoshmërinë e rrijtes së ndërgjegjësimit tek të gjitha shtresat e shoqërisë, në mënyrë që armiqëve të umetit të mos i jepet rasti për ta dëmtuar dhe për të hedhur poshtë planet e tyre për përçarjen e umetit në mënyrë që ky i fundit të angazhohet me çështjet e mëdha.

4- Konfirmojmë përdorimin e rrugës së dialogut, siç kemi deklaruar në vendimin nr.182 (19/8), si një mënyrë për të rrafshuar mosmarrëveshjet dhe konfliktet politike dhe konfliktet mes udhëheqësve që qeverisin me popullin dhe me partitë e ndryshme. Gjithashtu konfirmojmë mos-përdorimin e dhunës, forcës dhe armëve mes bijve të një umeti dhe vendi të përbashkët, si dhe largimin nga fanatizmi, sektarizmi dhe hizbizmi i ngushtë.

5- Konfirmojmë të drejtën e popujve për të patur drejtësi, dialog, bashkëpunim dhe siguri për një jetë fisnike mes të gjithë klasave shoqërore, për të bërë të mundur realizimin e objektivave të larta të umetit.

6- Konfirmojmë domosdoshmërinë e qëndrimit përkrah popujve të dobët që vuajnë nga një numër i madh i padrejtësive, konflikteve, dhunës dhe mungesës së sigurisë, sepse besimtarët janë vëllezër, me argument thënien e Allahut të Lartësuar: **“Vërtetë, besimtarët janë vëllezër.”**

7- Konfirmojmë të drejtën e popujve për liri dhe për ndryshimin e dukurive të këqija, si dhe të drejtën e tyre për të urdhëruar për punë të mira me forma paqësore dhe brenda kornizave të Legjislacionit Islam.

Asambleja i bën thirrje bijëve të umetit, prijësëve dhe popujve që janë pjesë përbërëse e tij, si dhe forcave politike, dijetarëve dhe mendimtarëve, që të qëndrojnë në një radhë të vetme për të shmangur rreziqet që i rrethojnë, në mënyrë që vendet e tyre të rikthehen në rolin që u takon karshi umetit.

Asambleja, me cilësinë e një institucioni ndërkombëtar që buron nga Konferenca Islamike për Bashkëpunim i bën thirrje udhëheqësve e shteteve që të bashkëpunojnë dhe

të shtojnë përpjekjet e tyre për të punuar më shumë për sheshimim e padrejtësive dhe kthimin e sigurisë në ato shoqëri që e kanë humbur atë. Lusim Allahun e Lartësuar që të ruajë umetin tonë nga çdo e keqe dhe ta udhëzojë atë tek më e mira. Vertetë, vetëm në dorën e Tij është sukcesi.

Gjykimi rreth themelimit të një faltoreje për të treja fetë bashkë

*Komisioni i Përhershëm i Fetvasë
Mbretëria e Arabisë Saudite
Fetvaja nr 6364 v.2 fq. 119*

Pyetje:

A lejohet përgatitja e një faltoreje të vetme për praktikimin e tre feve bashkë; hebraike, krishtere dhe islame? (pra një faltore që të jetë sinagogë, kishë dhe xhami në të njëjtën kohë).

Përgjigje:

Një gjë e tillë nuk lejohet sepse pjesëmarrja e përbashkët mes tre feve tregon se ajo faltore nuk është themeluar mbi devotshmëri[1] por është themeluar për t'i shoqëruar Allahut shok dhe ortak dhe për të adhuruar tjetër kënd përveç Tij, ndërkohë nuk ka fe tjetër të saktë përveç fesë islame. Për këtë kemi ajetin kuranor ku Allahu i Madhëruar thotë: **“Kush kërkon tjetër fe përveç Islamit, nuk do t'i pranohet dhe ai në botën tjetër do të jetë i humbur.”** (Surja Ali Imran, 85).

Gjykimi i vendosjes së kryqit në trup dhe kur del nga feja ai njeri

*Komisioni i Përhershëm i Fetvasë
Mbretëria e Arabisë Saudite
Fetvaja nr 2245 V.2 fq.119*

Pyetje:

Jemi futur në debat mes nesh për çështjen e një muslimani i cili ka vendosur kryqin në trupin e tij, që është dhe simboli i fesë kristiane. Disa prej nesh gjykojnë se ai njeri është bërë kafir (ka dalur nga feja) pa diskutim. Kurse disa të tjerë janë mendojnë se ai nuk konsiderohet kafir (jo besimtar) pa ia qartësuar më parë çështjen në fjalë dhe pa diskutuar mirë me të duke i treguar se po bëhet fjalë për simbolin e të krishterëve.


Përgjigje:

Shkoqitja në çështje të tilla është detyrë (vaxhib). Atij duhet t'i bëhet e qartë gjykimi i vendosjes së kryqit


në trup dhe se ai është simboli i fesë kristiane. Gjithashtu kjo është një punë që tregon se njeriu e pëlqen këtë gjendje të tij dhe se ai është i kënaqur me përkatësinë e tij si kristian nëpërmjet këtij simboli. E nëse ai pas këtij qartësimi vazhdon i vendosur në këtë veprim atëherë mund të gjykojmë se është bërë kafir (ka dalur nga feja). Për këtë që thamë kemi argument ajetin kuranor ku Allahu i Lartësuar thotë: **“Vërtet ai që miqësohet me ta, ai është prej tyre. Me të vërtetë Allahu nuk e udhëzon në rrugë të drejtë zullumqarët (keqbërësit)”** (Surja El-Maide, 51). Zullumqarët kur përmenden në Kuran bëhet fjalë për jobesimtarët që kanë bërë shirk të madh.

Përveç kësaj, vendosja e kryqit tregon për rënien dakort në pretendimin e të krishterëve të cilët thonë se Isai a.s (Krishti) është kryqëzuar, ndërkohë Allahu i Madhëruar e mohon kategorikisht këtë pretendim në Kuranin Famëlartë ku thotë: **“Por, ata as e vranë, as e kryqëzuan, por ashtu u është dukur. Ata që nuk u pajtuan për çështjen e tij, me siguri që gjenden në dyshim për të, por vetëm kanë hamendësuar. Ata, në të vërtetë, nuk e kanë vrarë”** (Surja En-nisa, 157).

[1] Ka për qëllim ajetin kuranor ku Allahu i Lartësuar thotë: **“Ti në atë xhami kurrë mos fal namaz. Ndërsa xhamia e themeluar në përkushtim (ndaj Allahut) që në ditën e parë, pa dyshim që është më e denjë për të falur namaz në të. Aty ka njerëz që duan të pastrohen. Allahu i do ata që pastrohen shpesh”** (Surja Et-eube 108).



**Lidhja e Hoxhallarëve
të Shqipërisë**
رابطة أئمة البانيا
**The Albanian
Imam's League**



www.lidhjahoxhallareve.com
Adresa: Rr. Teodor Keko (Unaza e Re)
P. Eglis, Kati III, Tirana-Albania
Mob1: 00 355 672304520
Mob2: 00 355 672753789
E-mail: lidhjahoxhallareve@yahoo.com

“GOLD AG”

Nga hoxhë Ulvi Fejzullahu

Një emër i cili paska nam në muzikë, por ja pra që unë s'kam haber në këtë fushë!!

Detyrimisht, po të imponohet të njoftohesh edhe me disa hesape të fushave tjera.

Tani, ky djalosh me zanatin e vet ja paska thënë si rreptë disa gjërave me emër e mbiemër, e me adresë!

E gjithë ky marifet ka aktivizua debatin në rrjetet sociale, pasi që kemi edhe një numër të “xhematiit” në fcb, pashë kalimthi disa komente, shpjegime, analiza, mendime, debate, fetva, e shumëçka tjetër.

Besa edhe gazetatat islamofobe, dhe islamofobët u aktivizuan për ta “kryqëzuar” djaloshin në fjalë, se paska përkrahur Islamin dhe disa hoxhallarë radikal!!

Të nderuar!

Më këtë djalosh, do të zgjedh një mënyrë tjetër komunikimi dhe atë që dëshiroj t'ia them do të bëj këtë në formën më të mirë dhe private. Lus Allahun të më udhëzoj mua dhe “Gold Ag” në rrugën e Imanit, Islamit dhe Ihsanit.

Kurse juve të tjerëve që gjetet kohë dhe harxhuat energji, me dije e padije, me axhele, do t'ua kisha kujtuar këto këshilla dhe porosi, shpresoj të jeni zemër hapur. (këto këshilla vlejné edhe për vetë Ulviun):

- Të këshillosh do të thotë t'i japësh

dikujt një porosi duke e ndihmuar për t'u përmirësuar që t'i zhdrukë të metat dhe të ndreqë gabimet, do të thotë ta paralajmërosh nga rreziqet, të sillet mirë dhe të veprojë si duhet. Këtë duhesh ta bësh me mjaftë edukatë dhe kompetencë.

-Por t'i japësh dikujt këshillë do të thotë t'u përmbahesh rregullave të caktuara të tërësisë së normave të sjelljes, me mjaft butësi dhe urtësi, duke iu shmangur përbuzjes, përçmimit, paragjykimimit.

- Kur dëgjoni për një vëlla besimtar ndonjë fjalë, ajo ka mundësi të ketë dy kuptime, atëherë etike është që ta mbartësh në vetvete si një të mirë.

- Kur shihni gabimin e bërë nga një musliman, jeni të detyruar ta këshilloni dhe ta drejtoni, por kjo gjithsesi të behet në vetmi, jo në mënyrë publike para njerëzve.

- Besimtari këshillues asnjëherë nuk ka për qëllim përgojimin dhe publikimin e të metave.

- Ka dallim mes këshillës së dhënë me të gjitha normat etike dhe skandalit duke bërë zhurmë të madhe për gjërat e papëlqyera që janë në kundërshtim me normat morale.

Të nderuar muslimanë!

Kini frikë Allahun e Lartësuar dhe gjithashtu kini parasysh se disa këshillëdhënës dhe kritikë nëpër tubime, forume, takime, libra e gazeta bien në gabime të ndryshme.

Kështu që këshilla po skandalizohet, përkujtimi po bëhet me nam, por këtë nuk e do Islami.

Besimtari duhet të jetë mburojë për besimtarin duke mos e cënuar sedrën e tij. Çdo herë fjalët dhe veprat e tij duhet të arsyetohen sipas mundësive.

Pa dyshim që besimtari gabon dhe rrëshqet, por ai vazhdimisht duhet të jetë i kujdesshëm në pendimin dhe kthimin e tij.

Këshilloj së pari veten dhe lus Allahun të më falë për gabimet e mia.

Islami

Islami si emër?!

Islami si mbiemër?!

Islami si një emër i një njeriu të thjeshtë,

apo, si një emër i një personaliteti ?!

Islami si fe?!

Islami si doktrinë,

apo, Islami si legjendë?!

Sido që të jetë,

nuk është ky Islami i vërtetë.

I pluhurosuar, i vjetëruar, si një anije e braktisur,

por pishtar i pashuar, që botën mbarë mbajti zgjuar,

kur një kaos e pat zaptuar.

Ah..., Islami.

Islami i ri e modern?

Petku “i bukur” që të ven.

Islami tek unë?!

Islami tek ti?!

Islami tek një grup diku atje?!

Ah..., të mjerët ne, që nuk luftojmë për Islamin fe.

Megjithatë, ti triumfator je edhe pse s'të mbrojmë dot ne.

Islami në shënjestër, në lojë.

Islami hesht, është pa gojë, se s'ka kush ta prezantojë.

Gjithçka, televizione, gazeta e revista uzurpojnë,

s'lanë gjë pa thënë,

me egërsi e mlllef gufo-

jnë, trup e shpirt s'kursëjnë,

armë e strategji ndërtojnë, kohë e lekë shpenzojnë,

Islamin fe përdhe ta rrëzojnë, në themel ta shkatërrojnë.

Të përloitur jemi, nga dhimbja e madhe që kemi.

Por jo. Nuk shuhet dhimbja në letër, amaneti është besë, e nuk është bojë për t'u tretur.

Hall e vaj medet ç'na ka gjet!

Ku jeni o ymet?

Veten pyesni: “Gjallë jemi”?!

Se veç ama, një gjë mirë ta dini, për ne kurrëgjë s'mbeti!

Nga: Dr. asc. Gerald Xhafer Hala

(...vijon nga faqja 1)

Fetarsia nuk është e kufizuar tek rrobat e trupit, por janë ndjenjat, emocionet dhe tendencat që dalin nga zemra dhe përkthehen në sjelljen e jashtme të gjymtyrëve. Nëse besnikëria mbahet përmes një rrethi të ngushtë me një farë paraqitjeje të jashtme, shoqëria do të ndahej në fraksione të vogla që do të jenë antagonistë ose të paktën jobashkëunuese me njëra-tjetrën. Këto ndarje priren të zmadhohen deri në një pikë sa njerëzit ndjejnë se nuk kanë asgjë të përbashkët mes tyre.

Si rezultat, është tepër e rëndësishme që ne t'i vëmë çështjet e paraqitjes së jashtme në perspektivën sesi Islami i ka paraqitur. Ne nuk duhet të neglizhojmë ato çështje ose të zvogëlojmë rëndësinë e tyre. Ata janë shprehje të jashtme të besimit. Ata të cilët i mbajnë ato bëjnë mirë dhe ata të cilët i dhunojnë mësimet islame përsa i përket atyre bëjnë gabim. Por aty mbetet vlerësimi. Ato të cilët sillen në këtë mënyrë nuk meritojnë të kenë çdo mbivlerësim dhe virtyt që i atribuohet për shkak të paraqitjes.

Këto çështje nuk duhet të trajtohen sikur ato të jenë principet e fesë mbi të cilat besnikëria dhe mosaprovimi, dashuria dhe armiqësia duhet të bazohen. Ashtu sikurse askush nuk ka të drejtë të nënçmojë mësimet e fesë sonë për paraqitjen e jashtme, barabarë askush nuk ka të drejtë t'i zmadhojë rëndësinë e tyre dhe t'i deklarojë njerëzit si fetarë ose të pandershëm mbi vetë llogarinë e tyre.

Asnjë person me mendje të shëndoshë nuk mund të kundërshtojë faktin që prezenca e disa karakteristikave të devotshme tek një person nuk do të thonë domosdoshmërisht që ai tërësisht përbrenda është i devotshëm. E ngjashme me këtë është se mungesa e disa karakteristikave të virtytshme nuk do të thotë se personi është përbrenda jo i devotshëm. Nëse të gjithë ne jemi të aftë ta njohim këtë fakt, atëherë pse disa prej nesh i bëjnë të tilla paraqitje të jashtme si tregues të devotshmërisë faktorin deçiziv se ku të vendosin besnikërinë dhe miqësinë tonë?

Një personi mund t'i mungojnë

disa cilësi virtuoze ose të tjera, por ka të tjera cilësi të mira që janë shumë më të rëndësishme. Një person mund të ketë një zemër të pastër një gjuhë që e kontrollon veten nga përgojimi dhe të folurit keq, ide të shëndosha, karakter të mirë dhe drejtë ndaj të tjerëve, bujari në shpenzime bamirësie, i devotshëm në fjalë dhe integritet në përmbushjen e detyrave të tij ndaj të tjerëve.

A duhet të gjitha këto cilësi madhështore të hidhen për shkak se personi i mungon paraqitja e jashtme?

A nuk duhet që një person që ka të tilla cilësi të ndershme të jetë më i dashur tek zemrat tona sesa kushdo tjetër i cili e ka paraqitjen e “fetares” por karakteri i të cilëve ka cilësi të tilla të shëmtuara që paraqitja e tyre e jashtme nuk mund kurrë as të shpresojnë të maskojnë, si dikush i cili nuk sillet mirë ndaj të tjerëve, flet vrazhdë dhe budallallëqe, i cili i mohon njerëzve të drejtat e tyre, është ziliqar dhe i cili urren dhe mendon keq për vëllezërit e tij musliman?

Ne kemi nevojë t'i rregullojmë nocionin tonë të fetares që njerëzit

kanë. Ata kanë nevojë të kuptojnë që nuk është e kufizuar tek pak vetë, parime specifike që kanë lidhje me paraqitjen e jashtme, as ekskluzivitetin ndaj ndonjë grupi që e dallon veten me mënyrën sesi paraqiten. Në këtë mënyrë ne do të mbrojmë veten tonë nga të gënjerit nga paraqitja. Shumë njerëz për të përfutuar ndere me ata të cilët duan t'i mashtrojnë përdorin paraqitjen si maskë. Duke e rregulluar nocionin tonë të fetares ne do të bëhemi të aftë t'i shmangemi ashpërsisë që njerëzit ja tregojnë njëri-tjetrit mbi llogari të gjykimeve të tyre nga vëzhgimi që nuk shkon përtej një vështrim të parë paragjykues.

Së fundi, unë nuk dua që askush të më keqkuptojë dhe të mendojë që unë jam duke i marrë mësimet fetare të paraqitjes sonë si të parëndësishme ose që unë jam duke thënë se është në rregull neglizhimi i atyre çështjeve. Jo, kjo nuk është aspak ajo që them. Unë vetëm po them që rëndësia e këtyre çështjeve nuk duhet të ekzagjerohen deri në atë pikë sa çështjet e tjera të rëndësishme të nënçmohen.

DISA KONCEPTE TË GABUARA TË ADHURIMIT DHE MORALIT ISLAM TEK MASA E SHQIPTARËVE (3)

Nga hoxhë Emerim Koçi

55 – Bërja e hallvës nga familjarët e të vdekurit pas varrimit të tij me bindjen se ajo largon pikëllimin e të dashurve të tij.

56 – Bindja se kush ha i pari nga hallva e përgatitur për një të vdekur ka radhën që të vdesë.

57 – Moskërkimi i diturisë apo i ndonjëshkence që ka nevojë një popullsi muslimane, e cila nuk bie ndesh me parimet e besimit islam me pretekst se ka prejardhje jo islame, por adresa e fesë islame është dituria.

58 – Besimi se nëse i pari fëmijë lind vajzë është argument mallkimi, besim i dikurshëm i politeistëve injorantë arabë para zbritjes së Kuranit.

59 – Besimi se të martuarit me dy, tri deri në katër gra ka qenë dispozitë e veçantë vetëm për kohën e Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, por për këtë kohë nuk vlen.

60 – Besimi se homoseksualizmi është dukuri normale.

61 – Besimi se kamata lejohet në këtë kohë, duke mos harruar se kamata është shpallje luftë kundër Allahut.

62 – Besimi se lejohet të shërohet me gjëra që ka ndaluar Allahu dhe Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, si p.sh. me vajin e derrit dhe çdo gjëje që i përket atij etj.

63 – Besimi se synetia e meshkujve është traditë injorante.

64 – Besimi se lyerja e pragut të shtëpisë me mjaltë apo hedhja e grurit në fytyrat e mysafirëve nga nuset e posardhura në shtëpinë e burrit sjell bereqet në jetën bashkëshortore.

65 – Besimi se mosprishja e virgjërisë së gruas në natën e parë të martesës është argument mallkimi i asaj gruaje.

66 – Të besuarit se romët, ashkalintjët nuk mund të bëhen muslimanë menjëherë me shqiptimin e shehadetit pa ndërruar 30 fe.

67 – Besimi se nuk ka pendim absolut për ithtarët e bidateve dhe thirrësit në të, edhe pse pendimi i tyre rrallëherë realizohet.

68 – Besimi se dijetarët dhe hoxhallarët duhen të jenë të pagabueshëm.

69 – Besimi se Allahu qëndron kudo, ndërkohë që argumentet kuranore, profetike dhe konsensusi i dijetarëve islamë aludojnë se Ai

qëndron mbi Arsh, por me dije Ai është kudo.

70 – Përqeshja e dispozitave të fesë islame apo mosbesimi në aftësitë dhe zotësitë e fesë islame si fe universale për të gjitha kohërat.

71 – Besimi se këndimi i mevludit sjell lumturi për të vdekurit dhe bereqet dhe shëndet për të gjallët.

72 – Besimi se të vdekurit dëgjojnë në varret e tyre gjithmonë.

73 – Besimi se nata e Regaibit është natë në të cilën nëna e Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka mbetur shtatzënë me të. (Allahu e shkatërroftë atë që ka shpikur këtë besim!)

74 – Pretendimi i dikujt se e ka parë Allahun në ëndërr.

75 – Besimi se dikush ka mundësi ta shohë Allahun në këtë botë absolutisht e pamundur, por në botën tjetër besimtarët do ta shohin Allahun në Xhenet.

76 – Të argumentuarit me caktimin e Allahut për mosudhëzim në fenë e Tij apo mosukses në jetë.

77 – Groposja e librave fetarë me bindjen e moskeqpërdorimit të tyre.

78 – Të porositurit e të afërmve para vdekjes që kufomën e tij ta djegin apo ta hedhin në det.

79 – Ndarja e pasurisë në mënyrë të njëjtë për djemtë dhe vajzat, ndërkohë që Sheriati porositi dy hise djalit, një hise vajzës. Urtësia e kësaj qëndron në atë se femra nga lindja deri në martesë e ka të siguruar jetën (ushqimin dhe veshmbathjen) nga babai i saj, kurse pas martesës është nën kujdesin e burrit, kurse mashkulli pas martesës fillon jetë të re dhe ka nevojë për dy hise për ndërtimin e kësaj jete.

80 – Bindja se Muhamedi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka qenë melek.

81 – Puthja e Kuranit para se të fillohet leximi i tij apo kur të kapet herën e parë në dorë.

82 – Bindja se nëse nuk i thuhet dikujt menjëherë pas përfundimit të namazit në xhami “Allahu kabull”, namazi është i mangët.

83 – Bindja se temxhidi është ibadet që duhet të realizohet patjetër para varrimit të të vdekurit.

85 – Bindja se të vdekurin duhet ta pastrojnë vetëm hoxhallarët apo hoxheshat.

86 – Bindja se fëmija i posalindur nuk lihet në një dhomë vetëm për një kohë të shkurtër, të paktën pa

lënë në atë dhomë edhe fshesën e dorës (klasike) që ta shoqërojë.

87 – Bindja se mbulimi i fytyrës së fëmijës së posalindur me petk të verdhë i largon atij zverdhin apo sarillëkun.

88 – Tallja se mbajtja e mjekrës është sunet, kurse rruajtja e saj farz.

89 – Besimi se ngritja e duarve para dhe pas rukusë në namaz nuk ka bazë në asnjë medhheb.

90 – Bindja se shërimi në spital apo të shëruarit me barna është bidat.

91 – Bindja se Turqia ka fenë më të fortë ndaj të gjitha vendet e tjera muslimane.

92 – Tallja e disa mendjelehtëve se shqiptarët e kanë prejardhjen nga Ademi alejhis selam dhe se ai ka qenë shqiptar, saqë sipas tyre edhe “historianët e kanë vërtetuar këtë”.

93 – Bindja se copëtimi i bukës me dorë është më i bereqetshëm, kurse prerja e saj me thikë i ngjason jomuslimanëve.

94 – Bindja se kush ha thërmijat e bukës më shumë, Allahu ia shton pasurinë më tepër.

95 – Konsiderimi i arabëve në tërësi si magjupë, në shenjë nënçmimi, Zoti na ruajtë. Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka qenë arab dhe Kurani është në gjuhën arabe.

96 – Tallja dhe bindja se Allahu të gjithë njerëzit do t'i fusë në Xhenet me pretekst se Allahu nuk e ka krijuar askënd me zor- siç ka ditur të na krijojë ashtu ka për të na futur në Xhenet. Kjo tallje njeriun e nxjerr nga besimi në mosbesim.

97 – Besimi se martesat e Muhamedit me shumë gra kanë ndodhur sepse ka qenë epsharak, një bindje e pjellë nga të krishterët.

98 – Besimi se varrimi i muslimanëve dhe i të krishterëve apo i feve të tjera në një vend është e lejuar.

99 – Besimi se shiat dhe sunitë janë vëllezër. Kjo vëllazëri nuk ka mundësi të realizohet kurrë ashtu siç nuk ka mundësi deveja të futet në vrimën e gjilpërës.

100 – Martesa e fëmijëve – djemve dhe vajzave- sa janë në djep.

101 – Bindja se femrat aq janë të djallëzuara, saqë edhe shejtanin e fusin në shishe.

102 – Shikimi në trupin e femrës apo të mashkullit lakuriq me bindjen e lejimit, se ky meditim në

krijimtarinë e Allahut është shkak për shtimin e besimit dhe forcimit të tij, besim i dervishëve ekstremë.

103 – Shikimi i femrave të huaja me bindjen se është e lejuar sepse Allahu e do të bukurën, edhe ky besim i dervishëve ekstremë.

104 – Dërgimi i fëmijëve për pagëzimin e tyre te shehlerët e tarikateve të ndryshme me shpresë që të bëhen evlia.

105 – Dërgimi i djemve para ose pasi të bëhen synet në tyrben e Sulltan Muratit, duke u sjellë rreth varrit të tij shtatë herë e më pas vendosja e kapeles që qëndron mbi varrin e tij në kokën e synetliut me shpresë që të bëhet sulltan me nam si Sulltan Murati.

106 – Mospirja e ujit nga gota e qelqit apo mosngrënia e ushqimit nga enët e porcelanit në datën 10 të muajit Muharrem, me bindjen se Husejni, nipi i Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, kur është vrrarë atë ditë e kanë detyruar të pinte ujë dhe të hante ushqim të përzier me baltë. Në shenjë solidarizimi me dhembjen e tij ushqimi dhe uji duhet shërbyer vetëm në enë prej balte. Ky është besimi i shiave të devijuar.

107 – Besimi se Homeini ka qenë musliman i mirë.

108 – Ndarja e besimit islam në shariat, hakikat dhe marifet: tre komponentët kryesorë të dervishëve në përfitimin e gradave si myrid, myhib dhe sheh.

Dije, o lexues i sinqertë, Allahu të ruajtë nga çdo e keqe, që u mundova të hedh sado pak dritë mbi gabimet më të përhapura të shqiptarëve, të cilat bien ndesh me besimin e pastër islam, me qëllim që t'i largohen devijimit. Nëse kjo temë ia ka qëlluar të vërtetës në përgjithësi, pranoje dhe përhape për hir të Allahut dhe lëri arsyet e pabaza dhe përtacinë. Në anën tjetër, nuk çuditem po ta sulmosh dhe kritikosh këtë artikull pa argumente sepse shumica e njerëzve në këtë kohë janë aq të prishur, saqë nuk di si t'i përshkruaj ndryshe nga ajo siç i ka përshkruar njëri nga dijetarët e selefit njerëzit e kohës së tij: **“Ishin njerëzit dikur si gjethi i butë pa ferra, por sot janë ferra pa gjethë.”**

Nëse hesht të shajnë, nëse flet të nënçmojnë, nëse i braktis të akuzojnë dhe të sulmojnë”.

Aktualitet/ GODITET “TERRORIZMI” NË SHQIPËRI, APO GODITJE TERRORI?

Nga hoxhë Bilal Shkrepi

Agimi i 11 Marsit ishte ndryshe për disa struktura shtetërore dhe me lajm të bujshëm për mediat. Prokuroria e Krimeve të Renda po atë dite deklaroi se: “ne bashkëpunim të plote me Policinë e Shtetit”, arrestuan organizatorët, ndihmësit dhe financuesit e të shume kërkuarës ne me shume se një dekadë “organizate terroriste” ne Shqipëri. Është kthyer gati ne bindje mes shqiptareve që institucionet e pavarura tek ne mund të kenë bashkëpunim të plote me njëra tjetrën, pikërisht kur kane urdhër, ose trysni nga faktori i huaj. Mbase edhe ne rastin e këtyre arrestimeve të bujshme kërkesa a urdhri ka qene po nga te huajt! Fundja perse te mos jete kështu, kur një “organizate terroriste” që rrezikon kaq shume Shqipërinë dhe rajonin, nuk lejohet që shqiptaret të ndjekin nëpërmjet medias procesin, ndërkohë që media raporton se një shtetas amerikan ka filmuar seancën e pare gjyqësore për dhënien e masës se sigurisë, arrest me burg.

Duke iu referuar shtypit, rrjedhjet nga dosjet hetimore s’kane qene te pakta, e meqenëse organet vazhdojnë te lejojnë rrjedhje, s’besoj që bëjmë gabim te komentojmë ne te tjerët. Deri me sot, askush nuk na ka thënë se kur kjo “celule kaq e rrezikshme” i ka bere thirrje anëtarëve te saj që te godasin Gjykatën Kushtetuese, Kuvendin e Shqipërisë, Ministrinë e Mbrojtjes, apo kur ka rekrutuar shqiptar që te shkojnë te luftojnë kundër ushtareve shqiptar ne Irak apo Afganistan. Gjithë ç’ është thënë deri me tani e nuk është faktuar prej prokurorisë përpara gjykatës, se personat e arrestuar kane rekrutuar njerëz për ne Siri.

Çështja e te arrestuarve është ne duart e prokurorisë deri ne momentin kur do te kaloj për shqyrtim ne gjykate, prej së cilës edhe do te ketë një shpallje vendimi në fund. Deri atëherë është detyrim, por edhe ne te mirën e gjithkujt që te pres me durim mbylljen e procesit, me shpresën që hetimi dhe gjykimi do te behet vetëm mbi fakte dhe prova te qena, aspak të sajuara, apo manipuluar, pa asnjë ndikim tjetër te brendshëm a te huaj, i cilitdo karakteri qofte.

Uroj që te arrestuarit te shpallen te pafajshëm, kjo për te mirën e tyre, për te mirën e shoqërisë dhe për te mirën e imazhit te vendit tone.

Pafajësia e dëshiruar e te arrestuarave, nuk ç’ bën aspak faktin e vajtjes se disa shqiptareve ne Siri dhe pjesëmarrjen e tyre ne konfliktin e armatosur ndërmjet popullit që kërkon çlirimin prej zgjedhës diktatoriale mbi dyzet vjeçare te familjes Esed dhe regjimit esedis



nga ana tjetër që nuk nxori mësim nga ndryshimet e shumta ne rajon dhe mendoi se nëpërmjet dhunës se tej skajshme e krimeve do mbyste kërkesën popullore, ndërkohë që ne KS dhe arenën ndërkombëtare mbështetëj tek vetoja dhe diplomacia, Ruso-Kineze.

Megjithatë, nga sa kuptohet problemi i institucioneve shtetërore ne Shqipëri me shqiptaret nuk është pjesëmarrja e tyre ne konfliktin sirian, sepse opozita siriane mbështetet nga perëndimi, por pjesëmarrja e tyre ne grupet e klasifikuara nga OKB si grup terrorist.

U miratua edhe një pakete e re ligjore ne kuadër te luftës kundër terrorizmit. A mjafton si garanci vetëm miratimi i shtrëngesave ligjore dhe zbatimi tyre?

Nëse organet shqiptare do mendojnë vetëm për masa shtrënguese dhe zbatimin e tyre kundër shqiptareve që dëshirojnë te kthehen nga Siria, atëherë do te lenë te hapur shtegun për shume kënd nga familjaret, te afërmit, te njohurit e atyre personave, por edhe për shume te tjerë ne shoqërinë tone, që te mendojnë se nuk është aftësia, drejtësia dhe dashamirësia ajo që drejton dhe vendos ne këtë vend. Apo, se ne këtë vend islamofobia ka depërtuar deri ne institucionet me te rëndësishme te vendit. Sikundër s’është aspak çudi që te mendohen te dyja së bashku. Do te ngushtojnë ne mos do i mbyllin mundësitë që ata shqiptar te kthehen ne vendin e tyre, gjë që as ata nuk do i ndihmoje, por as edhe imazhin e vendit (për te cilin qahen para ekraneve dhe arsyetojnë masat shtrënguese) nuk do ta ruajnë.

A gjenden te gjithë shqiptaret ne radhët e Xhebbetu en-nusre’s, apo shtetit fantazmë te Irakut dhe Shamit? Sigurisht që jo. A ekziston mundësia që këta shqiptar a një pjese e tyre te kenë udhëtuar drejt Sirisë dhe t’i jene bashkangjitur

këtyre grupacioneve përpara se ato te klasifikoheshin si terroriste? Sigurisht që po. A ekziston mundësia që këta shqiptar apo një pjese e tyre t’i jene bashkangjitur këtyre grupimeve, pa ditur se kujt po i bashkëngjiten? Sigurisht që ekziston, personalisht jam i bindur që kështu ka ndodhur. Nga sa kam dëgjuar rreth 90% e atyre shqiptareve që kane udhëtuar drejt Sirisë nuk kane ditur arabisht, keshtu që është e kuptueshme që as kane ditur gjë ku shkojnë, ç’ndodh ne territorin e gjere te Sirisë dhe se kush është al-Nusra apo Isis’i. Nuk është çudi që shume prej tyre t’u jete folur për një çështje sublime, lufte me fronte te qarta, si dhe zona te çliruara ku mund te besh jete idealiste. Ne te kundërt, si mund te shpjegohet fakti që një pjese jo e vogël e shqiptareve kane shkuar atje me gratë dhe fëmijët e tyre te vegjël, te cilët për çdo grup luftarak, apo terrorist do te ishin barre e panevojshme.

Duke iu referuar mediave, udhëtimet e para te shqiptareve drejt Sirisë kane rreth dy vite, ndërkohë që hetimet e organeve kompetente kane rreth dhjete muaj. Nga kjo kuptohet lehtësisht që për rreth pesëmbëdhjetë muaj organet shtetërore, ose s’kane ditur gjë (dhe kjo është fatkeqësi) ose kane bere sikur gjë s’po ndodh (fatkeqësia e këtij rasti është edhe me e rende). Cilado qofte, perse shkojnë taksat tona tek këto organe, ndërkohë që s’dinë te ruajnë shqiptaret dhe Shqipërinë? Apo që te mbeten te afta për sigurinë e krahëve politik dhe te forta për shantazhe mes tyre?!

Po t’i referohemi edhe videove te disa hoxhallarëve shqiptar te diplomuar ne boten arabe, apo profileve te tyre ne rrjete sociale, mësojmë se ata kane ndaluar udhëtimin e shqiptareve drejt Sirisë, por edhe kane paralajmëruar për rrezikun e rënies ne rrjetin e Nusres dhe Isis-it.

A është e rastësishme që te paret

te cilët kane bere thirrje te hapur ne Shqipëri për mos vajtjen e shqiptareve ne Siri kane qene hoxhallarët shqiptar te shkolluar ne boten arabe, përpara sesa te klasifikoheshin nga OKB si grupacione terroriste, ndërkohë që organet kompetente janë sjelle si shurdhe te verbëra? Apo mos valle qarqe brenda këtyre organeve shtetërore mezi kane pritur te ndërtojnë një skeme, kinse te goditjes se Shqipërisë nga terrorizmi?

Hoxhallarët shqiptar, serish u kane bere thirrje shqiptareve me ato mjete që kane mundur që te distancohen prej atyre grupacioneve dhe te kthehen ne vendin e tyre.

Pyetja që lind është, përballë kësaj situate, institucionet e shtetit me këta shqiptar a do te sillen me frymën e sigurimit te shtetit, a shtetit policor që ngrihet mbi frymën e ndëshkimit, ne emër te ligjit, apo do te sillen ne frymën e se drejtës dhe te bashkëpunimit për përmirësimin e asaj që duhet ndrequr?

Klima e krijuar druaj se po tregon që fryma do te jete ajo e ndëshkimit dhe jo e përmirësimit. Historia e terrorizmit ne bote s’ka lindur ne Shqipëri, po është edhe eksperiencat ne luftën kundër tij. Vendet ne luftën kundër terrorizmit kane pasur qasje dhe rezultate te ndryshme. Me e keqja mbase ka qene qasja e konstatimit te fenomenit, hartimit te ligjit ndëshkues dhe dënimit e fajtorit, apo edhe te dyshuarit, sipas ligjit. Kjo qasje ka treguar joefikasitet ne luftën kundër terrorizmit dhe fitoren ndaj tij. Kjo qasje pavarësisht sesa e ka tulatur, e ka bere atë me te sofistikuar, si dhe ka prodhuar heronj. Me efikase ka qene ajo e ngritjes se institucionit te debatit, nëpërmjet te cilit është bere e mundur njohja me ideologjinë, argumentet, arsyetimin, si dhe dyshimet ne ideologjinë dhe bindjen e grupacioneve që prodhojnë ide dhe ushtrojnë akte terroriste. Nëpërmjet institucionit te debatit konstruktiv një pjese e shteteve te prekura nga idetë dhe aktet terroriste, kane mundur te zhbëjnë devijimet ideologjike, te sqarojnë keqkuptimet dhe te çrrënjosin indoktrinimin nga mendjet e infektuara, duke vendosur thelbin e debatit pikërisht ne bazat dhe argumentet e atyre ideologjive. Debatit ne këto vende ka qene publik, jopublik, ne ambiente fetare, ne ambientet e heqjes se lirisë, nëpërmjet librave dhe letërkëmbimeve. Rezultatet e kësaj qasje ne ato vende që dashamirësisht e kane ngritur debatin, kane qene te kënaqshme dhe bindëse ne çrrënjosjen e indoktrinimit nga personat e infektuar prej ideve dhe bindjeve ekstremiste. (vijon në fq. 6)

CIKLI I HADITHEVE TË DOBËTA

Nga hoxhë Mustafa Tërniqi

HADITHI NR 20 :

Xherir el-Bexhli tha: "Ishim në grumbullimin e haxhinjve gjatë Haxhit të Lamtumirës të të Dërguarit të Allahut (a.s), kur arritëm në një vend të quajtur Ghadir Khumm. Ai thirri për namaz në xhemat, ndaj ne muhaxhirët dhe ensarët u mblodhëm. Atëherë i Dërguari i Allahut (a.s) u ngrit në mesin tonë e tha: "O njerëz! Për çfarë dëshmoni? Ata u përgjigjën, 'Dëshmojmë se nuk ka zot përvec Allahut.'" Ai tha, 'Po tjetër?' Ata u përgjigjën, 'Dhe se Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Tij' Ai tha: 'E kush është Wali-u i juaj?' Ata u përgjigjën: 'Allahu dhe i Dërguari i Tij janë Wali për ne.' Atëherë ai e kapi Aliun për krahu dhe e bëri të ngrihej në këmbë, duke ia tërhequr krahun dhe duke i mbajtur parakrahët e tij. Atëherë ai tha: 'Kujtdo të cilit Allahu dhe i Dërguari i janë wali, atëherë ky njeri i është wali! O Allah, kushdo që ta urrejë, bëhu urreyes i tij.'" (E ka transmetuar Taberaniu dhe el-Mutteki el-Hindi

në Kenz ul-Ummal, vëll VI, fq 154të shkurtuar dhe el-Hejthemiu në Mexhma' uz-Zeëa'id)

Grada e hadithit: Sic shikohet në fund të transmetimit përmenden dhe referencat ku gjendet ky transmetim dhe tek referencat shënohet dhe el-Hejthemiu. Do të ishte e udhës dhe prej besnikërisë që bashkë me të të përmendej dhe vetë fjala e Hejthemiu i cili kur e përmend këtë transmetim ne librin e tij "Mexhmeuzzevid 9/106 e bën të dobët këtë transmetim duke thënë: "Në zinxhirin e këtij hadithi qëndron Bishr ibn Harb i cili është i dobët si transmetues dhe po aty ka persona të tjerë që nuk i njoh." Sic shikohet imam El-Hejthemi nuk e ka përmendur hadithin thjesht si transmetim por ka sqaruar dhe gradën e tij dhe pse është i dobët dhe prej besnikërisë dhe amanetit të dijeve islame është që të përmendet fjala e tij deri në fund dhe mos të fshihen të vërtetat vetëm e vetëm që të shtohen sa më shumë transmetimet për Aliun r.a në mënyrë që të përmbushen

qëllimet që kemi përmendur në hadithet e kaluara ku kërkohet me çdo kusht që Aliu duhet të njihet dhe të prezantohet si njeriu më i mirë në mesin e sahabëve. Ndërkohë transmetimi në fjalë, në zinxhirin e tij ndodhet dhe Harb ibn Surejxhi të cilin e konsiderojnë të dobët në transmetime Imam Buhariu, Ibn Hibbani, Ibn Adijj dhe të tjerë.

HADITHI NR 21 :

Transmetohet prej Ibn Mardawejhit dhe ibn Asakirit, të dy prej Ebu Sa'id el-Khudriut se ky ka thënë: 'Kur i Dërguari i Allahut (a.s) e emëroi Aliun ditën e Ghadir Khummit dhe bëri thirrje për pranimin e wilajetit të tij, Xhibrili i zbriti Profetit (a.s) me ajetin "Sot plotësova fenë tuaj..."

Grada e hadithit: Ky lloj transmetimi nuk shënohet në koleksionet e sakta të haditheve por as tek transmetimet e sakta të tefsirit, komentimit të Kuranit. Për këtë arsye imam Ibn Kethiri në Tefsirin e tij 5/53 thotë se ky transmetim nuk është i

vërtetë dhe bie në kundërshtim me transmetimet e sakta që tregojnë se ajeti i lartpërmendur ka zbritur në ditë tjetër dhe për qëllim tjetër ndryshe nga çpërmendet në këtë transmetim jo të saktë. Siç shikohet përpjekjet për ta bërë Aliun më të mirin e sahabëve janë të vazhdueshme dhe në forma të ndryshme duke e servirur figurën e tij të lidhur me fillimin dhe mbarimin e Islamit. Në këtë transmetim përshembull përpjekjet shiite janë për ta bërë fenë islame përmbyllëse me figurën e Aliut, ku pretendohet se ajeti që flet për përmbylljen e fesë bën fjalë për wilajetin e Aliut, apo sic njihet ndryshe tek shumë shiite; merita që ka pasur Aliu për të qenë prijësi i besimtarëve që pas vdekjes së Pejgamberit (a.s). Mirëpo argument të tilla janë të dobëta dhe kundërshtojnë transmetimet e sakta dhe historinë islame, pjesë e së cilës është vetë Aliu me fjalët dhe veprat e tij, që tregojnë qartë për respektin dhe autoritetin që gëzonin Ebu Bekri dhe Umeri tek ai.

(...vijon nga faqja 5)

Institucioni debatit për probleme të kësaj natyre në nivel ekspertesh dhe njerëzish të ditur me qëllim ndërgjegjësimin dhe ndreqjen e mendjeve të indoktrinuara, mungon në vendin tone. Mungon si institucion pranë KMSH-se, mungon edhe shprehja e vullnetit për ngritjen e tij në bashkëpunim të ndërsjellët ndërmjet eksperteve brenda dhe jashtë KMSH-së, në nivel subjektsh a individësh, e me pas KMSH-ja mund ta ngrëjë edhe në nivel bashkëpunimi me institucionet e shtetit, si p.sh MD.

Njeriun nuk e bën terrorist mendimi, por akti, njëlloj siç nuk e bën politikanin tradhtar mendimi që t'i shërbejë interesave dashakeqe ndaj Shqipërisë, për shkak të përfitimeve personale, por akti tradhtar ndaj interesave të vendit. Ndaj vlen debati që të parandalojmë aktin dhe të mjekojmë burimin e sëmundjes.

Ndërsa pjesa e dënimit me ligj dhe zbatimit të tij ndaj shkelësve të tij, vjen pas kësaj faze, ndërkohë që kush ka qene duke vuajtur dënimin dhe është penduar prej asaj ideologjie, ka përfituar amnisti.

Ndaj edhe rezultatet midis këtyre modeleve kane qene dallueshëm të mëdha.

Është detyrë e shtetit që të beje me të mirën e mundshme për të mirën e shtetasve dhe vendit të tij, në mënyrën me të drejte.

Në videot e ofruara prej mediave të

ndryshme, ne lidhje me implikimin e te arrestuarve në thirrjen për pjesëmarrje në konfliktin e armatosur në Siri, a me keq akoma, ne atë të nxitjes për akte terroriste, s'na zunë veshët asgjë të tilla.

Megjithatë, është detyrë e medias dhe ne nderin e saj që të mbulojë dhe raportoje lajmin drejt dhe saktë. Mirëpo ka të tilla në mesin e medias që kane kapërcyer kufijtë e objektivitetit dhe profesionalizmit, dikush duke shpallur fajësimin e te arrestuarve, ndërkohë që gjykata s'ka thënë ende fjalën e saj, dikush tjetër, duke mbushur kronikat televizive a faqet e gazetave me imagjinate të shfrenuar, kinse në Shqipëri kjo "organizate terroriste" dispononte arsenal armesh të cilin do e transportonte drejt Sirisë për organizimin e akteve terroriste. Me siguri që armët do i transportonin nga te njëjtat rruge ajrore dhe tokësore që edhe udhëtonin shqiptaret drejt Sirisë! Ka prej mediave që e kane trajtuar lajmin, njëkohësisht edhe vetveten deri në piken me qesharake të mundshme, me demok paskan intervistuar një agjent sekret a te infiltruar që kurrë s'kish pasur mundësi të hynte në xhami, apo te kontaktonte ndonjërin prej anëtarëve të kësaj "organizate terroriste" e cila nuk lejonte të hynte kush në xhami pa u identifikuar si i lejuar që të hyje. Apo mos ndonjë prej këtyre mediave ka nostalgji për kohën e sigurimit të shtetit, ku individi dënohej, sepse sigurimi mendonte që ai mbase mendonte

ndryshe nga vija e sigurimit?

Pikërisht kësaj i thonë: belaja me e keqe është ajo që te bën të qeshesh.

Kjo pjesë e mediave që lajmin e ka trajtuar në mënyrë jo objektive dhe larg profesionalizmit, a ndjehet ndopak e shqetësuar, apo fajtoje për klimën sociale që prodhon raportimi i saj? A kane edhe ato përgjegjësi për klimën dyshuese dhe paragjyquese që prodhohet brenda familjes, ambienteve të punës, shkollave, institucioneve publike e deri tek dyqanet, autobusët dhe kafenet? Si mund të marr fund kultura e vetëgjyqësisë në këtë vend, ndërkohë që një pjesë e mediave të gjykon dhe shpall vendim, ndërkohë që prokuroria punon për plotësimin e dosjes që do paraqesë përpara gjykatës? Ku përfundoj roli i tyre në luftën kundër diskriminimit? A kane pare këto media se ç'komente shkruhen në faqet e tyre online, apo neper blogje të ndryshme? A ndjehet përgjegjësi edhe ato për ndjenjën e islamofobisë që krijohet?

A është e pranueshme që subjekte mediatiqe të shkelin ligjin dhe të kontribuojnë qofte edhe pa dashje në nxitjen e urrejtjes ndaj një bashkësie fetare në vend?

Apo te ngushëllohem me faktin që jetojmë në Shqipëri?

Prej kohësh qarqe të ndryshme që nuk gjejnë pikëtakimin e interesave të tyre me interesat e Shqipërisë, një nga kartat që kane përdorur kundër Shqipërisë, në procesin e saj integrujes ka qene edhe karta e

terrorizmit islamik. Batak ne te cilin janë tërhequr dhe përdorur edhe islamofobet shqiptar. A është në nderin e ndonjë subjekti mediatiq në Shqipëri që t'u shërbejë këtyre interesave?

Një pjesë e medias ka shkelur ligjin, ka shkelur rregullat baze në profesionin e gazetarisë si edhe kodin etik, duke u bere në këtë mënyrë një kontribuues aspak i drejte dhe i denje për zgjidhjen e situatës në vendin tone.

Qarqet antishqiptare jo paqëllim godasin Shqipërinë në një mënyrë a tjetrën nëpërmjet Islamit. Sepse ka qene pikërisht roli vendimtar i hoxhallarëve dhe myslimaneve në momentet me të rëndësishme dhe me kritike të vendit, ai që ka mbrojtur identitetin, interesat dhe territoret e Shqipërisë dhe shqiptareve. Ne rastin e pavarësisë, ne rastin e mbrojtjes së trojeve nga serbet, greket dhe çdo pushtuesi tjetër. Kështu që, duke goditur myslimanet dhe duke i shfaqur në sytë e popullit të tyre si njerëz të cilët nuk e duan vendin, nuk ju intereson te mbrojnë interesat e vendit do kenë me të lehte realizimin e planeve dhe projekteve të tyre në kurriz të Shqipërisë dhe shqiptareve. Ndaj kur gabon një individ a grup myslimanesh, mos trajtohet problemi sikur të tilla janë myslimanet, duke krijuar kështu, terror në mendjet e shoqërisë, sepse mysliman janë shumica e popullsisë së këtij vendi.

EDUKATA MBI MËNYRËN E KRYERJES SË NEVOJËS PERSONALE NË KËNDVËSHTRIMIN ISLAM

Nga Dr. asc: Gerald Xhafer Hala



Me këtë material dëshiroj dhe synoj të informoj çdokënd mbi kujdesin që duhet të ketë gjithësecili mbi mënyrën e kryerjes së nevojës personale, duke i treguar rreziqet që kërcënojnë shëndetin e njeriut apo higjenën e tij vetjake, në rastin e mosrespektimit të normave që duhet të kihet parasysh gjatë kryerjes së nevojës personale apo kryerja e saj jo në mënyrën e duhur, si dhe duke vënë në pah anët pozitive dhe dobite që ka njeriu në rastin e kryerjes së nevojës personale sipas mënyrës Islame, të argumentuara këto me fakte mjekësore dhe argumente llogjike. Ky material s'është gjë tjetër, vetëm se një përfaqje shkencore dhe edukative, diktuar nga i dërguari i Allahut, mësuesi më i mirë i njerëzimit Muhamedi (sal-Allahu alejhi ue selem), mbi mënyrën e kryerjes së nevojës personale. Le t'i paraqesim shkurtimisht argumentet mbi këtë temë të ndara në disa pika si vijon më poshtë:

A)-Në rastin kur nevojat personale kryhet ulur (Parantezë-Dallimi i VC-ve ka veçoritë përkatëse. P.sh lloji i VC-së së sheshtë (tradita Islame) dhe lloji i VC-së së ngritur (tradita jo Islame).

Dëmet:

1-Në rastin kur nevojën personale e kryejmë në VC tip i ngritur dhe në të ka qenë një njeri i sëmurë nga lëkura (Dermatit) dhe që këtë sëmundje do ta kishte të shprehur apo të përhapur edhe në zonën përreth kofshëve, atëherë ai do të bëhej burim i përhapjes së asaj sëmundjeje tek të gjithë ata që do të kryenin nevojën personale në të njëjtën mënyrë në të njëjtën VC.

2-Siç dihet mashkulli ndryshon nga një femër në organet urogjenitale. Duke qenë se organi urogjenital i mashkullit në gjendje të relaksuar ose jo do të prekte në

sipërfaqet e brendshme të VC-së, atëherë do të ishte i pamundur evitimi i një infeksioni nga një gamë e madhe sëmundjesh.

3-Siç dihet urina del nga rrugët e traktit urinar me një farë presioni si tek mashkulli ashtu edhe tek femra. Edhe në këtë rast, nëse përpara do kishte qenë një person i infektuar klinikisht ose jo, atëherë stërklrat (piklat) e urinës do të binin në mënyrë të pashmangshme në rajonin gjenital si të mashkullit ashtu edhe të femrës, të cilët pa dashje do të merrnin infeksione tepër të rrezikshme, jo vetëm për traktin urogjenital por edhe për shëndetin në përgjithësi. Kjo do të ishte një mëkat i madh në rastin e një nëne shtatzënë, gjë e cila do të rrezikonte jetën e fëmijës së saj, që krahas mundit me aq dëshirë e pret.

B)-Në rastin kur nevojat personale (urina) kryhet ngritur.

Si mashkulli ashtu edhe femra do të ishte më mirë që urinën ta kryenin në VC-në e sheshtë, pasi siç dihet nëse nevojat personale (urina) do të kryhej në VC-në e ngritur, atëherë trupi apo rrobat do të ndoteshin dhe kjo gjë nuk është aspak e shëndetshme dhe as higjenike. Këtë feja islame e ka ndaluar, pasi ne si muslimanë duhet të jemi të pastër nga ndytësitë si në trupin tonë ashtu edhe në rrobat tona. Për këtë ekziston një thënie e Profetit (sal-Allahu alejhi ue selem) ku thotë: **"Se gjysma e besimit është pastërtia"**. Përveç kësaj ka edhe shumë thënie të tjera, të cilat kanë lidhje me pastërtinë dhe ruajtjen prej ndytësive. Profeti (sal-Allahu alejhi ue selem) na ka porositur që të bëjmë kujdes, të ruhem prej pikave të urinës gjatë kryerjes së saj, madje ai na ka lajmëruar se ka dënim për ata që kanë qenë të pakujdesshëm ndaj saj, siç transmetohet në një hadith ku Profeti (sal-Allahu alejhi

ue selem) ka kaluar pranë një varri dhe ka thënë: **"...Se ky (i vdekuri) është duke u dënuar për shkak se nuk ka qenë i kujdesshëm gjatë kryerjes së urinimit."** Muslimani quhet i papastër nëse është i përlyer me urinë, qoftë edhe me një pikë të vetme që mund t'i ketë rënë në trupin e tij apo në rrobat e tij, prandaj kjo është e një rëndësie të veçantë që duhet të kihet parasysh nga çdo musliman. Për ta evituar këtë, do të ishte mirë që ta kryejë atë në VC-në e shtrirë, pasi edhe nëse do të pikohej nga pikla të urinës do ta kishte më të lehtë për t'u pastruar, jo vetëm kaq por një gjë e tillë do të shmangte edhe marrjen e sëmundjeve infektive nëpërmjet traktit urogjenital.

C)-Dallimet e të kryerit të aktit të defekimit në VC-në e shtrirë dhe në VC-në e ngritur. Dobitë dhe dëmet.

Konstatohet se në qëndrimin ulur gjatë aktit të defekimit në VC-në e ngritur, ky akt do të bëhej tepër i vështirë dhe shpesh herë i parealizueshëm. Vetë struktura anatomotopografike e zorrëve të trasha në lidhje me trupin ndodhet në pozicion të atillë, ku pjesa fundore e zorrës së trashë (Rektumit) është pingul me boshtin trupor. Nëse do të mund shikonim në këtë moment (pra gjatë aktit të defekimit), peristaltika e zorrëve është e shtuar dhe tepër e fuqishme, si pasojë e rritjes së tkurrjes së sinkronizuar të muskulaturës së lëmuar të zorrëve, e ndihmuar nga presioni që ushtrojnë organet e tjera të kavitetit abdominal apo edhe të organeve të kavitetit torakal, të cilët vazhdimisht ushtrojnë presion për të lehtësuar daljen e masave


fekale jashtë trupit. Pozicioni në të cilin ndodhet trupi në VC-në e ngritur nuk e favorizon aspak aktin e defekimit, por përkundrazi e rëndon situatën, pasi siç dihet trupi nuk është në pozicionin e tij të drejtë dhe presioni nuk bie plotësisht mbi pjesën fundore të zorrës së trashë, por mbi pjesën fundore të përparme të barkut, gjë që rrezikon për rrupturë të zorrëve të holla apo të fshikzës urinare dhe enëve gjakore të rajonit abdominal. Në rastet më të shpeshta shpie në hernie inguinale, si pasojë e sforcimeve të vazhdueshme mbi këtë rajon, apo e Hemorroideve te anusit, te cilat formohen si pasojë e stazave të enëve gjakore nga vështirësia e aktit të defekimit dhe zgjatja në kohë e këtij akti. Nëse nevojat personale do të kryhej ulur në VC-në e sheshtë, një energji (forcë që ndihmon mjaft) janë edhe muskujt e kofshëve, të cilët në këtë rast të pozicionimit të trupit ndihmojnë në zbrasjen e traktit tretës dhe jo vetëm kaq, por ato mbajnë të tendosura muskulaturën e barkut dhe nuk lejojnë organet që të shtyhen përpara, apo të krijojnë zhvendosje të tyre (Hernie). Pra, energjia e muskujve të kofshëve në qëndrimin ulur gjatë VC-së ngritur humbet për mbajtjen e pozicionimit të trupit në atë formë. Si konkluzion, mund të themi se kryerja normale e aktit të defekimit nuk ka të bëjë me modernizimin e VC-ve, por me natyrshmërinë e të kryerit të këtij akti dhe mënjanimin e ndërlikimeve të mëtejshme, që mund të vijnë si pasojë e mos pasjes kujdes gjatë këtij akti. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për kryerjen e aktit të urinimit.



MBLEDH ZEKATIN TUAJ

Për zekatin në lekë:
IBAN: AL 43 2051 6703 4163 29CL OTCL ALLB
Llogaria në lekë:
IBAN: AL 70 2051 6703 4163 29CL OTCL ALLA
Llogaria në Euro:
IBAN: AL 37 2051 6703 4163 29CL OTCF EURO
Llogaria në Dollarë:
IBAN: AL 81 2051 6703 4163 29CL OTCF USDA

Lidhja e Hoxhallarëve të Shqipërisë
Tel: 0672304520 /0672538334/048320160
BKT Banka Kombëtare Tregtare
Nr. i llogarisë : 52416329



NA VIZITONI NË KANALIN TONË NË YOUTUBE

Adresa: Rr. Teodor Keko (Unaza e Re)
P. Edglis, Kati i tretë
Email: lidhjahoxhallareve@yahoo.com



Adresa: Rr. e Kavajës,
rrugica përballë
xhamisë "Dine Hoxha", Tiranë
Cel: 0672812607 / 0672821589

PRODUKTE NATYRALE

Produkte bimore të cilësisë më të mirë nga vendet e lindjes!

Produkte të firmës "Phenomenal", vaj të farës së zezë
Mjaltë me polen, mjaltë sidri, etj.
Hurra arabie të freskëta dhe ujë zemzemi
Kremra të ndryshëm të firmës "Orchid" dhe vajra bimore "Tact"
Shampo bimore "Touch Me" nga Tajlanda
Parfume vajore (3 ml) me aroma të llojlojshme
Parfume me mbushje të markave më të njohura europiane
Misvak dhe pastë dhëmbësh me misvak
Këna bimore 100% natyrale për flokë dhe për duar
Kohël bimor për sytë etj.

www.produktenatyrale.com
Email: agimballa@hotmail.com

